



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 511, datë 24.09.2024

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 66, DATË 09.02.2023 “PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE
LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË: GJYKATËN
E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR, PËR POZICIONET E LIRA TË SHPALLURA ME VENDIMET
NR.499, NR.500, 501, DATË 21.11.2022; SI EDHE NË GJYKATAT E APELIT TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR POZICIONET E LIRA NË FUSHËN
E TË DREJTËS PENALE TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 502, NR.503, 504
DATË 21.11.2022 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85, pika 1 dhe nenin 86, shkronja “ë”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, të vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar, si dhe vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 “Për Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, vendimin nr. 361, datë 29.07.2024 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Alban Toro”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 66, datë 09.02.2023 “Për Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë

Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si më poshtë:

Caktimin e z. Markelian Koça si relator për kandidatët:

- z. {...}
- znj. {...}

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kandidatëve të përfshirë në pikën 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR